



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1151/prot.  
2

Tiranë më, 18.09.2020

UDHËZIM

Nr. 13, datë 18.09.2020

PËR

**“KRITERET PËR SHPËRBLIMIN PËR MERITA PROFESIONALE TË  
OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE TË SEKSIONEVE”**

Në mbështetje të nenit 148/b, shkronja “dh”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 38, pika 2, shkronja “k”, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 30 paragrafi 5 i ligjit nr. 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”,

UDHËZOJ:

Neni 1

**Propozimi për vlerësim**

1. Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm i propozojnë Prokurorit të Përgjithshëm, shpërblim për merita profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në prokurorinë që drejton.
2. Për oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë së Përgjithshme, propozimi bëhet nga drejtuesi i strukturës pranë të cilës ushtron funksionet oficeri i policisë gjyqësore.
3. Propozimi që i dërgohet për miratim Prokurorit të Përgjithshëm, duhet të përmbajë përshkrimin e shkakut të vlerësimit, masën e shpërblimit dhe sipas rastit të shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm që shërben për një vlerësim të saktë të meritave të veçanta profesionale të oficerit të policisë gjyqësore dhe masës së shpërblimit.

## Neni 2

### **Kriteret për shpërblim**

Drejtuesi i prokurorisë/drejtuesi i strukturës në Prokurorinë e Përgjithshme, për të propozuar shpërblim për merita profesionale të oficerit të policisë gjyqësore, duhet të evidentojë një ose më shumë nga këto kriteret:

- a) njohuri dhe zotërim të kompetencave të specializuara, jo të zakonshme, në lidhje me teknologjitë speciale dhe disiplinat teknike;
- b) prodhimtari më të lartë se mesatarja ose angazhim për të punuar jashtë orarit;
- c) menaxhim shumë i mirë i çështjeve komplekse, për shkak të numrit, rëndësisë ose ndjeshmërisë së krimeve, numrit të të pandehurve, implikimeve ndërkombëtare, kërkit të analizave/vlerësimeve të provave të shumta, situatave emergjente dhe rrezikshmërisë së veprimtarisë;
- ç) rezultatet e arritura në koordinimin e grupeve të mëdha hetimore dhe bashkëpunimin me grupe të tjera, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- d) cilësinë e lartë të akteve procedurale/dokumentacionit të hartuar;
- e) vlerësimi “shumë mirë” i rezultateve të punës për vitin paraardhës kalendarik, kur oficeri i policisë gjyqësore ka marrë vlerësimin maksimal në çdo kriter vlerësimi.

## Neni 3

### **Zbatimi**

Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga drejtuesi i prokurorisë/drejtuesi i strukturës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Financës në Prokurorinë e Përgjithshme.

## Neni 4

### **Shfuqizime**

Urdhri nr. 1, datë 19.09.2011 i Prokurorit të Përgjithshëm, “Për përcaktimin e kriterëve për shpërblimin për merita profesionale të oficerëve të Policisë Gjyqësore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**PROKUROR I PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**

